

Data 26.01.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburant per ngrohje nevojat e Shkollave te pajisura me kaldaje dhe per mjetet e Q.A

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0 (karburante)

VLERA E FONDIT LIMIT:

➤ **1.350.000 (nje milion e treqind e pesedhjetë mijë) leke pa tvsh.**

Ne baze te nenit 76 pika 1 germa b) VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimete e tregut , bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- d) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

➤ **Grupi i punes, i ngritur me urdher te brendshem Nr.04 date 25.01.2023 te drejtorit te Qendres se Arsimit, u mbeshtet në çmimet e publikuara ne faqen e**

APP-së, në Njoftimin Nr. 2060 Prot., datë 23.03.2022 mbi çmimet e karburanteve, ne Banken e Shiperise per kursin zyrtar te kembimit, per te llogaritur fondin limit per kete procedure.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra e Arsimit, Lushnje, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Shtojcës3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojcës 8*
- c. Formulari ofertes sipas shtojces 1,2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë

duhet të paraqesin: - Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te realizuar nga Operatori ekonomik gjate 3 (tre) viteve te fundit (**2019,2020,2021**) te leshuar nga Administrata Tatimore ku vlera e xhiros duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. *Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqese: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Mars te vitit qe vjen, sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe neni 43, pika 2/c te VKM-së Nr. 285 date 19.5.2021, ku përcaktohet nder te tjera se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019,2020,2021** , të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit

Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate** (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten e vlefshme:

- Operatori ekonomik duhet te paraqesi certifikate **ISO 9001 : 2015** (Sistemi i menaxhimit te cilësisë), objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit; ose Ekuivalente (Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- **ISO 14001:2015** për sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1 ”Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

- **Preventivi për realizimin e objektit të prokurimit i hartuar nga inxhinieret është si me poshte vijon;**

Nr	Përshkrimi i mallit	njesia	Sasia e pritshme
1	“Blerje Karburant për ngrohje nevojat e Shkollave të pajisura me kaldaje dhe për mjetet e Q.A	liter	8339

Afatet e lëvrimit: Afati kohor për levrimin e mallit , duke filluar nga data e lidhjes së kontratës brenda 15 (pesëmbëdhjete) dite kalendarike.

- **Specifikimi i tollonës së naftës:**

- 1.Lloji i karburantit; Gazoil 10 ppm ULSD
- 2.Sasia e litrave në tollon-10 litra.
- 3.Muaji.
- 4.Viti.
- 5.Ngjyra të ndryshme sipas llojit dhe muajit.
- 6.Nr. i sërisë.
- 7.Formati i tollonës me përmasa 50mmX90 mm.

1. OE duhet të paraqesë leje tregtimi ose Autorizim për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil 10 ppm) bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera”- *i ndryshuar*.
2. Liçensë për tregtimin e karburantëve të leshuar nga Ministria Përkatëse ose Autorizim për tregtimin e karburantëve të leshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore
3. Të ketë 1 (një) pikë shitje karburanti në pronesi ose me qera të provuar me dokument ligjor (ekstrakti tregtar i QKR-së i shoqëruar me dokument pronësie ose kontratë qeraje) brenda

territorit të Bashkisë Lushnje në një distancë jo më shumë se **5 km** nga adresa e Autoritetit Kontraktor.

4. Të paraqesë një çertifikatë të cilësisë të karburantit që kërkohet të prokurohet, nga Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre ose nga laboratorët të specializuar për këto analiza.
5. Sa më sipër, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave me specifik të veçantë, gjykojmë se kriteret e kërkuara që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin deklaratë se garanton furnizimin me karburant sipas standardeve shtetërore në fuqi S.SH.EN 590 : 2017 për Gazoil me tollona të vlefshme në pika shitje karburanti dhe se operatori duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në distancën e kërkuar., të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” nenit 40, pika 5, gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT:

